



Pranuar / Dorezuar Primi/je/Prodato Received/Delivary	21.09.2022	2	viti god veç.
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa a Pislog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMS/HEK	5576/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.721/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtare, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.721/2022 të datës 22.08.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 21.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Komisioni për Grada dhe Disiplinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh(15) nga data e pranimit të këtij vendimi të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 06/09/2021 të ankuesit

II. Detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrativ që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.

II Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 22.08.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 4837/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, për mosdhënien e gradës diplomatike në kuadër të Komisionit për Grada dhe Disiplinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 30.08.2022 ka proceduar

kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit me datë 09.09.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4837/2022 të datës 22.08.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 06.09.2021 të M. Krasniqi drejtuar Zyrës së Sekretarit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Akt Emërimit të datës 05.09.2012 të ankuesit; Kontratën me Nr.ref.MPJ-Da-005/1; Vërtetimin me Nr. Prot:214/2014 me (data e pamundur të evidentohet), lidhur me përvojën e punës së ankuesit; Vendimin me numër protokollit 07/5569 të datës 24.07.2007; Kontratën mbi vepër me NR. Prot 071/08 të datës 29.09.2008; Kërkesën për qasje në dokumente publike me referencën DFSHP-ZTL-10-2022 18.03.2022; Vendimin me Nr.1107/2022 të datës 30.03.2022; Emalin e datës 30.03.2022 të drejtuar Emalin e datës 12.08.2022 të drejtuar Formularin për vlerësimin për nëpunësit e shërbimit të jashtëm të datës 27.10.2021; Formulari i vlerësimit për nëpunësit të shërbimit të jashtëm për vitin 2020; Kontratën e Marrëdhënies së punës me Nr.ref;MPJ-ZKA-002 me numër të kontratës 077/2008; Certifikatën e datës 21.04-29.04.2011 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar me sukses kursin themelore për ngasje emergjente; Formularin e vlerësimeve për nëpunësit e shërbimit të jashtëm të vitit 31.10.2016; Diplomën universitare me numër 3858/0321 të datës 16.09.2020; Certifikatën e datës 16.07.2018 lidhur me trajnimin një ditor "Siguria Kibernetike"; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm të datës 16.10.2017; "; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm të datës 01.11.2018; Letër motivimin lidhur me kërkesën për gradim të datës 06.09.2021; Vërtetimin me Nr. prot 214/2014 të datës 18.03.2014; Kontratën mbi vepër me Nr.prot071/2008; Kërkesën për grada e datës 06.09.2021 drejtuar Komisionit për grada dhe disiplinë; Emalin e datës 22.08.2022 të drejtuar KPMSHCK-se; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.08.2022 me numër të protokollit 5035/2022; Përgjigjen në ankesë të datës 09.09.2022 me numër të protokollit 5263/2022; Emalin e datës 07.09.2022 të drejtuar Akt emërimit me numër të protokollit 2111 të datës 13.06.2022; Emalin e datës 26.05.2022 të Zyrës së Sekretarit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, drejtuar Emalin e datës 06.09.2021 të drejtuar Zyrës së Sekretarit në Ministrinë e Punëve të Jashtme; Vendimin me numër 07/5569 të datës 24.07.2007; CV e ankuesit; Vendimin me NR.107/2022 të datës 30.03.2022; Procesverbali i mbledhjes së komisionit për grada dhe disiplinë i datës 09.06.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se është e domosdoshme që lënda të kthehet në detyrim të organi administrativ kompetent gjegjësisht Komisioni për Grada dhe Disiplinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, **SEPSE**:

Nga vlerësimi i provave të lëndës përkatësisht sipas Akt Emërimit me nr. akti 269 prot.2111 të datës 13.06.2022 është konstatuar se ankuesi ka statusin e nëpunësit civil dhe është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në pozitën "Zyrtar për Transport 1" në Departamentin për Shërbime të Përgjithshme, Divizioni për Logjistike dhe Shërbime.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nga shkresat e lëndës ka gjetur se organi i punësimit duke u bazuar në nenin 30 të Ligjit nr.03/L-122 dhe nenit 12 paragrafi 4 dhe nenin 14 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm ka shpallur shprehjen e interesit për gradim të zyrtarëve të MPJD-së, ndërsa afati për dorëzimin e kërkesave ka qenë nga

ata 03/09/2021 deri më datë 08/09/2021 me datën 03.09.2021 dhe bazuar në këtë thirrje të brendshme ankuesi me datë 06.09.2021 ka paraqitur kërkesë për gradim.

Pasi që ankuesi nuk kishte pranuar përgjigje nga Komisioni për Grada dhe Disiplinë, i njëjti më datë 18.03.2022 ka parashtruar kërkesë për qasje në procesverbalin e Komisionit për Grada dhe Disiplinë. Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me Vendimin Nr. protokolli 1114 të datës 30.03.2022 ka lejuar qasjen në dokumente publike parashtruesit të kërkesës gjegjësisht ankuesit Ndërsa ankuesit nga ana e zyrës se personelit i është lejuar qasja me datën 12.08.2022.

Nga procesverbali i Komisionit për Grada dhe Disiplinë të datës 09.06.2022 rezulton se Komisioni në fjalë ka vendosur ti refuzohet kërkesa për gradim me katër vota kundër asnjë votë pro ,asnjë abstenim për ankuesin duke arsyetuar se pozita në të cilën mbanë është pozitë e cila nuk ka asnjë lidhshmëri me punën në diplomaci.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ju referua dispozitave ligjore të nenit 28 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-122 Për Shërbimin e Jashtëm me të cilat është përcaktuar se: *Dhënia e gradave "1. Avancimi i nëpunësve të shërbimit të jashtëm bëhet duke u mbështetur në sistemin e gradimit. Elementet kryesorë në dhënien e një grade për anëtarin e shërbimit të jashtëm janë koha e shërbimit, kualifikimi dhe vlerësimi i rezultateve të punës. 2. Përveç gradës ambasador, gradat jepen nga Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës, mbi bazën e të dhënave që ndodhen në dosjen personale të çdo punonjësi dhe në bazë të vlerësimeve të bëra, sipas kritereve dhe rregullave të përcaktuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm",* ndërlidhur me këtë Rregullorja Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm konkretisht neni 12 paragrafi 2 ka paraparë se: *"2.Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlefshmërinë e caktimit të gradave të anëtarëve që hyjnë në Shërbimin e Jashtëm dhe gradimin e zyrtarëve në kuadër të sistemit për vlerësimin e rezultatit të punës, ashtu siç përcaktohet me këtë rregullore"* ndërsa në këtë kuptim duke mos paragjykuar vendimin e komisionit kolegji vlerëson se komisioni për grada në mënyrë të hollësishme duhet ta trajtoj kërkesën e ankuesit dhe të vendosë në mënyrë meritore përmes një akti administrativ siç parashihet në dispozitat e LPPA-së, nga se në rastin konkretë nuk është vepruar mbi bazë të këtyre dispozitave obligative në lidhje me trajtimin e kërkesave të kësaj natyre.

Andaj, në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenit 97 paragrafi 1 ku parashihet se: *1.Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ...."*, Kolegji duke u bazuar në faktin se Komisioni për Grada dhe Disiplinë nuk kishte nxjerrë akt administrativë konformë LPPA-së, i cili ligj specifikisht parashih strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativë, konstaton se një formë e tillë nuk është në harmoni me dispozitat e këtij ligji dhe se dokumenti i tillë në këtë rast procesverbali nuk i ka elementet e dosmosdoshme që parashihen për një akt administrativë ashtu si parashih neni 47 paragrafi 1,1.1,1.2,1.3 dhe 1.4,të cilat dispozita definojnë këtë qështje;*"1.Akti administrativ i shkruar përmban:1.1 pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datënxjerrjes;1.2 pjesën urdhëruese (dispozitivoin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit.1.3 pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4 pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku*

paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e njetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë” dhe bazuar në këto dispozita ligjore të specifikuara më lartë komisioni për grada dhe disiplinë në lidhje me kërkesën e ankuesit duhet të nxjerrë akt administrativë bazuar në këto dispozita ligjore.

Andaj mbi bazë të konstatimit të mësipërm kolegji konstaton se Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me rastin e trajtimit të kërkesës të datës 06.09.2021 të ankuesit për gradë siç parasheh legjislacioni i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk ka vepruar konformë dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga se përveç që si organ i punësimit ka ofruar procesverbalin e datës 09/06/2022 që është trajtuar kërkesa por se nuk na ka ofruar ndonjë dëshmi tjetër që i njëjti komision ka nxjerrë edhe aktin administrativë bazuar në dispozitat e nenit 47 të LPPA-së, që është obligim i komisionit që të nxjerrë akt administrativë në lidhje me këtë kërkesë, dhe mbi këtë bazë obligohet Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të nxjerrë akt administrativë në lidhje me kërkesën e ankuesit dhe i cili akt duhet të përmbajë të gjitha elementet siç parashihen në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht ashtu siç parasheh neni 47 i të njëjtit ligj.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 dhe 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.721/2022, datë 21/09/2022

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- ❖ Komisionit për Grada dhe Disiplinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- ❖ Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

